

Statuti **Koalicioni ShpresON #perShqiperine**

Preambulë e Statutit të Koalicionit ShpresON #PërShqipërinë

Në frymën e mbrojtjes së interesave kombëtare, ruajtjes së sovranitetit dhe promovimit të vlerave tradicionale shqiptare, ne, anëtarët themelues të Lëvizjes ShpresON #PërShqipërinë, deklarojmë vendosmërinë tonë për të kontribuar në ndërtimin e një shteti të drejtë, të fuqishëm dhe demokratik.

E frymëzuar nga aspiratat e popullit shqiptar për një të ardhme më të mirë dhe një shoqëri të bazuar në drejtësi, liri dhe dinjitet, Koalicioni ShpresON #perShqiperine angazhohet të ndjekë një vizion politik të bazuar në këto parime themelore:

Sovraniteti Kombëtar: Mbrojtja e interesave të kombit shqiptar kundër çdo axhende që kërcënon unitetin, integritetin dhe identitetin kombëtar.

Demokracia e Drejtpërdrejtë: Përfshirja aktive e qytetarëve në proceset politike, duke respektuar dhe zbatuar vullnetin e shumicës.

Patriotizmi dhe Bashkimi Kombëtar: Përpjekja për një bashkim strukturor dhe funksional të të gjitha trojeve shqiptare, si dhe integrimi i diasporës dhe mërgatës shqiptare.

Transparenca dhe Përgjegjshmëria: Përdorimi i mjeteve dhe metodave demokratike në veprimtarinë politike dhe institucionale, duke garantuar një qeverisje transparente dhe të ndershme.

Respektimi i Vlerave Tradicionale: Promovimi i familjes, jetës dhe traditave të pasura kulturore shqiptare, duke refuzuar axhenda që cenojnë integritetin e shoqërisë sonë.

Me këtë frymë, Koalicioni ShpresON #perShqiperine shpall angazhimin për të ndaluar shpopullimin e Shqipërisë dhe për ta kthyer Atdheun tonë në shtëpinë më të mirë për çdo shqiptar, brenda dhe jashtë kufijve të tij. Në këtë rrugëtim, ne do të përmbushim vizionin tonë për një Shqipëri të lirë, të fortë dhe të begatë, duke u mbështetur vetëm në mjete të ligjshme dhe kushtetuese.

Në mbështetje të legjislacionit shqiptar dhe specifikisht në ligjin Nr. 8580, datë 17.2.2000 PËR PARTITË POLITIKE (i ndryshuar) u vendos hartimi i këtij Statuti, me kushtet që përcaktohen si më poshtë:

KREU I

Neni 1

EMËRTIMI DHE FORMA E ORGANIZIMIT

Emërtimi i partisë politike është “Koalicioni ShpresON #përShqipërinë”, shkurt “Koalicioni #perShqiperine” e cila do të njihet ndryshe në këtë Statut me emrin “Koalicioni”.

Koalicioni është bashkim ne vullnet të lirë i shtetasve shqiptarë mbi bazën e ideve, bindjeve, pikëpamjeve, interesave të përbashkëta politike, të cilët synojnë të ndikojnë në jetën e vendit

nëpërmjet pjesëmarrjes në zgjedhjet dhe përfaqësimit të popullit në organet e zgjedhura të pushtetit. Koalicioni në veprimtarinë për arritjen e qëllimeve të saj, përdor vetëm mjete dhe metoda demokratike.

Neni 2

SELIA, SHTRIRJA TERRITORIALE, VULA DHE LOGO

Koalicioni zhvillon aktivitetin e saj brenda territorit të Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj për aq sa lejohet nga legjislacioni shqiptar dhe ai ndërkombëtar.

Koalicioni ka logon dhe vulën e saj që kanë këto të dhëna:

Koalicioni

ShpresON

#përShqipërinë

Selia e Koalicionit ndodhet në Tiranë dhe adresa shkruhet: Rr. Bardhok Biba, P.75, Sh.2, Nr 5, (Kati i Parë) Tiranë, Shqipëri

Neni 3

AFATI

Koalicioni do të zhvillojë aktivitetin e saj për një afat kohor të papërcaktuar

Neni 4

PROGRAMI

Themelet ideologjike:

Parti e djathtë, konservatore, reformiste, identitare, sovraniste, patriotike, antikomuniste, antikolonialiste, euroskeptike.

Pozicioni ideologjik ndërkombëtar:

Aspiron të jetë pjesë e spektrit politik ideologjik ku renditen forcat konservatore në SHBA (si Partia Republikane në epokën Trump) dhe Europë (si partitë e "Konservatorët dhe Reformistët Evropianë - ECR).

Qëllimi i Programit:

Shpëtimi i Shqipërisë nga Axhenda e Shpopullimit duke e bërë Atdheun tonë përsëri Shtëpinë më të mirë për të gjithë shqiptarët

Bazat e Programit të Koalicionit janë 10 shtylla si më poshtë:

1. Ndalimi i Axhendës Soros të Shpopullimit të Shqipërisë duke ndëshkuar të gjithë ata që luajtën rol në këtë krim kundër shqiptarëve.
2. Reformim i plotë duke krijuar një Sistem të Ri Politik Demokratik të vërtetë, bazuar tek liria, sovraniteti i popullit dhe ligji.
3. Transformimi i Shtetit shqiptar që të jetë më i miri, më i drejti dhe më inkurajuesi në zhvillimin ekonomik për të gjithë shqiptarët.
4. Shtetformim dinjitoz që ofron dhe garanton mundësi dhe standarde shërbimesh për të gjithë shqiptarët dhe jo vetëm për disa.
5. Bashkim Kombëtar strukturor kushtetues dhe ligjor, pas pas hapi, për çdo ditë dhe në çdo fushë, dhe rintegrim i diasporës dhe mërgatës shqiptare.
6. Korigjim i plotë, me urgjencë dhe me themel të Refomës Soros në Drejtësi duke garantuar pavarësinë, dhënien e drejtësisë dhe efikasitetin kohor dhe proceduriale.

7. Orientim i plotë i Shtetit pro familjes, pro jetës, pro fëmijëve kundër axhendave liberale të “shoqërisë së hapur” të ç’orientimit seksual të fëmijëve dhe ato që cenojnë Parimet Kushtetuese dhe Traditën familjare.
8. Edukimi patriotik, formimi, aftësimi i brezave të rinj për jetën, për familjen, për shoqërinë dhe kombin shqiptar.
9. Fuqizim të marrëdhënieve ndërkombëtare që bazohen vetëm në interesin dhe sovranitetin kombëtar dhe jo axhendave antishqiptare duke forcuar aleancat ndërkombëtare mbi parimin e interesit kombëtar. Ta bëjmë Shqipërinë një vend sovran dhe ta çlirojmë nga mallkimi i të qenit një Republikë Ambasadorësh dhe Çiflig i Familjes Soros.
10. Prona i takon të zotit, ndërsa pasuritë kombëtare popullit shqiptar.

Rruga e arritjes së zbatimit të programit do të jetë përfshirja e Koalicioni në konkurrimin elektoral dhe ajo do të përdorë vetëm mjete të ligjshme dhe kushtetuese në aktivitetin e saj politik, institucional dhe financiar.

Neni 5

DEMOKRACIA E BRENDSHME E KOALICIONI

Koalicioni është një parti që drejtohet nga parimi i demokracisë së drejtpërdrejtë nga poshtë lart duke i dhënë anëtarit jo vetëm të drejtën për të zgjedhur përfaqësuesit e vet por edhe për të marrë pjesë vetë në vendimmarrjen politike nëpërmjet votimit të drejtpërdrejtë për vendimet e saj.

Bazuar në parimin e demokracisë së drejtpërdrejtë dhe kolegjinale, udhëheqja politike redukton në maksimum rolin e kryetarit, duke lënë në minimumin e lejuar nga ligji kompetencat e një Kryetari (referuar legjislacionit për partitë politike dhe Kodin Zgjedhor) pasi Koalicioni do të udhëhiqet nga struktura kolegjinale.

Qeverisja e brendshme e Koalicioni

Organet drejtuese të Koalicioni janë:

KREU II

Periudha e Themelimit dhe Regjistrimit Juridik

Neni 6

KËSHILLI I BASHKËVEPRIMIT THEMELUES I KOALICIONIT

Këshilli i Bashkëveprimit Themelues i Koalicionit ka rolin e Grupit Nismëtar Themelues dhe përbëhet nga aktivistët të cilët marrin iniciativën për themelimin e Partisë.

Ai përbëhet nga 9 persona.

Ata garantojnë respektimin dhe ecurinë demokratike të themelimit dhe regjistrimit të Koalicioni. Ata vendosin me vullnet të lirë të miratojnë dokumentacionin themeltar përfshi:

“Karta e ideve, parimeve dhe qëndrimeve që na bashkojnë në Koalicionin ShpresOn #perShqiperine”

“Statuti i Koalicionit ShpresOn #perShqiperine”,

“Akti i Themelimit i Koalicionit ShpresOn #perShqiperine”,

“Programi i Koalicionit ShpresOn #perShqiperine”.

“Rregullorja e Organizimit të Brendshëm të Koalicionit ShpresOn #perShqiperine”

“Listë-Formulari i anëtarësimit dhe Mandatimit të Përfaqësuesve të Qytetarëve Themelues të Koalicionit ShpresOn #perShqiperine dhe miratimit të akteve themeluese të Koalicionit”

Ata zgjedhin me vullnet të lirë Këshillin e përkohshëm Koordinativ, Koordinatorin e përkohshëm të Organizimit, Sekretarin e përkohshëm të Këshillit, si dhe disa Koordinatorë të përkohshëm sipas fushave që kanë funksionin e anëtarit të Këshillit të Përkohshëm Koordinativ.

Mandati i tyre është i përkohshëm deri në 30 ditë pas regjistrimit të Koalicionit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Brenda 30 ditësh nga regjistrimi organizohet votimi për mandatimin elektoral të gjithë strukturave.

Mbledhja e Këshillit të Bashkëveprimit Themelues organizohet fizikisht brenda mundësive nëpërmjet pjesëmarrjes së kombinuar fizike dhe virtuale në platformat online sipas praktikave më të mira të aplikuara nga Komisionet e Ligjeve në Kuvendin e Shqipërisë. Mbledhjet njoftohen paraprakisht për të gjithë anëtarët e strukturës. Arsyeja e ndjekjes së kësaj praktike është pengesa ligjore për të siguruar burime financiare para regjistrimit në Gjykatë, në bazë të ligjit për partitë politike.

Neni 7

KËSHILLI I THEMELUES KOORDINATIV

Këshilli i Përkohshëm Koordinativ ka funksionin e Kryesisë së Përkohshme kolegjiale.

Ajo përbëhet nga 3-5 persona dhe është në numër tek.

Kompetencat e Këshillit të Përkohshëm Koordinativ, janë:

- a) Caktimi i Koordinatorëve Lokalë që do të ndihmojnë organizimin e Koalicioni në nivel lokal dhe mërgatë.
- b) Ndihma dhe Mbikëqyrja e procesit të regjistrimit të anëtarësisë, krijimi i **klubeve patriotike** në nivel lokal dhe në mërgatë me anëtarët themelues, zgjedhja e Përfaqësuesve të Qytetarëve Themelues, dhe garantimi i ndjekjes së procedurave demokratike dhe të rregullta.
- c) Marrja e vendimeve për qëndrimet dhe reagimet e Koalicioni në kuadër të të drejtave dhe përgjegjësisë që ka një formacion politik para regjistrimit në Gjykatë.
- d) Miratimi i Raporteve të Koordinatorit të Përkohshëm dhe Koordinatorëve Lokalë.
- e) Diskutimi dhe miratimi i akteve të nevojshme për përfundimin me sukses të dokumentacionit të regjistrimit juridik që propozohen nga Koordinatorin e Përkohshëm.
- f) Miratimi i mandateve të Përfaqësuesve Lokalë që do të dalin nga procedura e organizimit të Koalicionit.
- g) Miratimi i akteve dhe procedurave të organizimit të Asamblesë Themeluese të Përfaqësuesve të Koalicionit.
- h) Organizimi i Asamblesë Themeluese të Përfaqësuesve të Koalicioni.

Mbledhja e Këshilli i Përkohshëm Koordinativ organizohet fizikisht brenda mundësive nëpërmjet pjesëmarrjes së kombinuar fizike dhe virtuale në platformat online sipas praktikave më të mira të aplikuara nga Komisionet e Ligjeve në Kuvendin e Shqipërisë. Mbledhjet njoftohen paraprakisht për të gjithë anëtarët e strukturës. Arsyeja e ndjekjes së kësaj praktike është pengesa ligjore për të siguruar burime financiare para regjistrimit në Gjykatë, në bazë të ligjit për partitë politike.

Mandati i tyre është i përkohshëm deri në 30 ditë pas regjistrimit të Koalicionit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Brenda 30 ditësh nga regjistrimi organizohet votimi për mandatimin elektoral të gjithë strukturave.

Neni 8 KOORDINATORËT LOKALË

Koordinatorët Lokalë janë aktivistë themelues të Koalicioni të cilët shprehin vullnetin e tyre të lirë për tu angazhuar vullnetarisht për të ndihmuar në procesin e themelimit, anëtarësimit, organizimit të Koalicioni.

Ata regjistrohen nga Koordinatori i Përkohshëm dhe miratohen nga Këshilli Koordinues i Koalicioni.

Ata kanë kompetencë që të përdorin dokumentacionin e destinuar për ta dhe *“Listë-Formulari i anëtarësimit dhe Mandatimit të Përfaqësuesve të Qytetarëve Themelues të Koalicionit ShpresOn #perShqiperine dhe miratimit të akteve themeluese të Koalicionit”* për të regjistruar anëtarët dhe Përfaqësuesit e tyre.

Neni 9 PËRFAQËSUESIT E QYTETARËVE THEMELUES TË KOALICIONI

Përfaqësuesit e Qytetarëve Themelues të Koalicionit, janë aktivistë që mandatohen nga anëtarët themelues për të marrë pjesë në Asamblenë Qytetare Themeluese të Koalicionit.

Ata janë shtetas shqiptarë që jetojnë brenda dhe jashtë Shqipërisë.

Neni 10 “QYTETARËT THEMELUES” TË KOALICIONI

“Qytetar Themelues” të Koalicionit (anëtarët e Koalicionit) bëhet çdo shtetas shqiptar (që jeton brenda apo jashtë Shqipërisë) që shpreh vullnetin e lirë për të mbështetur me firmën e tij themelimin e Koalicionit ShpresON #perShqiperine nëpërmjet propozimit dhe miratimit të “Listë-Formulari i anëtarësimit dhe Mandatimit të Përfaqësuesve të Qytetarëve Themelues të Koalicionit ShpresOn #perShqiperine dhe miratimit të akteve themeluese të Koalicionit”

Ai ka të drejtë të zgjedhë dhe të zgjidhet në çdo nivel drejtimi dhe përfaqësimi, konform këtij Statuti. Ai ndërpret në çdo moment anëtarësimin e tij pa pasur nevojë të japë shkaqe, mjafton të dërgojë njoftimin e tij me shkrim apo virtualisht. Dorëheqja e tij konsiderohet e kryer në çastin që ky njoftim mbërrin me shkrim apo virtualisht në pikën e kontaktit të vënë në dispozicion nga Koalicioni.

Neni 11 KLUBET PATRIOTIKE TË KOALICIONIT

Klubet Patriotike të Koalicionit janë organizimi lokale, me bazë gjeografike apo profesionale, ideve apo interesave, dhe miratohen nga Këshilli i Përkohshëm Koordinativ me propozim të Koordinatorit të Përkohshëm.

Mënyra e organizimit të tyre dhe pozicioni i tyre brenda Koalicioni përcaktohen sipas rregullores së brendshme të organizimit të Koalicioni.

ASAMBLEJA QYTETARE THEMELUESE E KOALICIONIT SHPRESON #PERSHQIPERINE

Organi themelues i Koalicionit është Asambleja Qytetare Themeluese e Koalicionit ShpresON #Pershqiperine dhe ajo përbëhet nga Përfaqësuesit e Qytetarëve Themelues të Koalicionit.

Asambleja Qytetare dhe Roli i Deleгатëve

1. Përkufizimi dhe Qëllimi i Asamblesë Qytetare Themeluese
 - a) Asambleja Qytetare Themeluese është organi më i lartë vendimmarrës i partisë që thirret para dorëzimit të kërkesës për regjistrim në Gjykatë, për të miratuar dokumentacionin e regjistrimit në Gjykatë.
2. Thirrja dhe Organizimi i Asamblesë Qytetare
 - a) Asambleja Qytetare e zakonshme thirret sapo të përfundojë plotësimi i kriterëve ligjore të regjistrimit në Gjykatë nga Këshilli i Bashkëveprimit të Koalicionit.
 - b) Njoftimi për datën dhe rendin e ditës së Asamblesë bëhet publik jo më vonë se 31 Dhjetori 2024.
3. Përbërja e Përfaqësuesve (Deleгатëve)
 - a) Deleгатët janë përfaqësuesit dhe ndihmësit e mbledhjes së nënshkrimeve nga anëtarësia e Koalicionit sipas raportit jo më të madh se 1 me 100 anëtarë (1 delegat për maksimumi 100 anëtarë)
 - b) Numri i delegatëve përcaktohet proporcionalisht me numrin e anëtarëve themelues por nuk duhet të jenë më pak se 31 delegatë.
 - c) Deleгатët mandatohen në bazë të dokumentacionit të mbledhjes së nënshkrimeve.
 - d) Përfaqësimi në Asamble duhet të jetë proporcional në raport me shtrirjen e Koalicionit.
 - e) Lista e delegatëve publikohen në fillim të mbledhjes së Asamblesë dhe verifikohen nga Komisioni i Procedurave Statutore që zgjidhet me votim të hapur në fillim të Asamblesë, për të siguruar ligjshmërinë.
4. Të Drejtat dhe Detyrat e Deleгатëve. Deleгатët kanë të drejtë të:
 - a) Marrin pjesë në diskutime dhe të propozojnë rezoluta.
 - b) Votojnë për çështjet që i parashtrohen Asamblesë, përfshirë zgjedhjen e organeve të larta drejtuese konform kërkesës për regjistrim në Gjykatë.
 - c) Deleгатët janë të detyruar të përfaqësojnë qëndrimet e strukturës që i ka zgjedhur ose të deklarojnë pavarësinë e tyre në qëndrimet e tyre, duke pasur parasysh platformën dhe interesat e përgjithshme të partisë.
5. Funkcionet e Asamblesë Qytetare Themeluese
 - a) Zgjedhja e organeve drejtuese me votë të fshehtë:
 - a. Kryetarin e përkohshëm të partisë.
 - b. Këshillin e Përkohshëm të Bashkëveprimit që ushtron të njëjtat funksione si Këshilli i Bashkëveprimit sipas këtij Statuti. Ai zgjedh në përfundim të Asamblesë Këshillin Kordinativ të Përkohshëm që ushtron të njëjtat funksione sipas përcaktimeve të këtij Statuti të Këshillit Koordinativ deri në thirrjen e Asamblesë së zakonshme.
 - c. Komisionin e përkohshëm të Transparencës dhe Auditimit të përbërë nga 3 vetë i cili ushtron të njëjtat funksione sipas përcaktimeve të këtij Statuti për këtë Komision.

- b) Ndryshimet në statut (propozimet për ndryshime në statut diskutohen dhe miratohen me shumicën e cilësuar të votave të delegatëve).
 - c) Propozimin, Miratimin e rezolutave, mocioneve dhe dokumenteve strategjike:
 - d) Rezolutat që përcaktojnë drejtimit strategjike dhe politike të partisë miratohen nga Asambleja Qytetare Themeluese .
6. Procesi i Vendimmarrjes
- a. Në çdo rast bëhet verifikimi i mandateve të pjesëmarrësve
 - b. Asambleja në varësi të kushteve dhe mundësive zhvillohet në formë të alternuar të prezencës fizike dhe virtuale për ti dhënë mundësi dhe garantuar çdokujt sidomos përfaqësuesve të diasporës dhe mërgatës, që të marrin pjesë në procesin vendimmarrës. Është detyrë e Këshillit Bashkëveprues që ti garantojë kushtet e prezencës përfaqësuesve që marrin pjesë nëpërmjet platformave online duke garantuar edhe verifikimin e mandateve dhe garantojë shprehjen dhe pranimin e lirë të vullnetit të tyre në kushtet e sigurisë së plotë dixhitale.
 - c. Vendimet e Asamblesë merren me shumicën e thjeshtë të votave të delegatëve të pranishëm, përveç rasteve kur statuti kërkon një shumicë të cilësuar.
 - d. Votimet për zgjedhjen e personave janë të fshehta ndërsa ato për vendimet e tjera janë të hapura, përveç rasteve kur anëtarët e Asamblesë vendosin ndryshe.
 - e. Rezultatet e votimeve regjistrohen dhe bëhen publike menjëherë pas përfundimit të seancës.
7. Transparenca, Publikimi dhe regjistrimi i ndryshimeve që kërkon ligji
- a. Raportet dhe vendimet e Asamblesë publikohen brenda 48 orësh nga përfundimi i saj dhe i bëhen të njohura anëtarësisë së partisë dhe publikut.
 - b. Paraqitja e dokumentacionit në Gjykatë bëhet brenda afateve ligjore që përcakton legjislacioni dhe procedura gjyqësore.
 - c. Autorizimi i Kryetarit të Përkohshëm për të kryer procedurat e regjistrimit në Gjykatë.

KREU III

Periudha pas Regjistrimit Juridik të Koalicionit

Neni 12

ASAMBLEJA QYTETARE E KOALICIONIT SHPRESON #PERSHQIPERINE

Organi themelor i Koalicionit është Asambleja Qytetare e përbërë nga Përfaqësuesit e Qytetarëve Themelues të Koalicionit. Ajo organizohet nga Këshilli i Përkohshëm i Bashkërendimit që është zgjedhur nga Asambleja Qytetare themeluese.

Asambleja Qytetare dhe Roli i Delegatëve

1. Përkufizimi dhe Qëllimi i Asamblesë Qytetare
 - b) Asambleja Qytetare është organi më i lartë vendimmarrës i partisë, i thirrur periodikisht minimumi 1 herë në vit, për të adresuar çështjet themelore të politikave, organizimit dhe drejtimit të partisë.
 - c) Asambleja shqyrton dhe miraton platformën politike, statutet, raportet e organeve ekzekutive dhe planifikon drejtimit strategjike për periudhën pasuese.
2. Thirrja dhe Organizimi i Asamblesë Qytetare

- c) Asambleja Qytetare e zakonshme thirret minimumi një herë çdo 1 vit nga Këshilli i Bashkëveprimit të Koalicionit.
 - d) Asambleja e Jashtëzakonshme Qytetare mund të thirret me kërkesë të 1/3 së anëtarëve të Këshillit të Bashkëveprimit ose të 1/3 së delegatëve të Asamblesë.
 - e) Njoftimi për datën dhe rendin e ditës së Asamblesë bëhet publik jo më vonë se 30 ditë përpara zhvillimit të saj dhe në rastet e Asamblesë të Jashtëzakonshme Qytetare bëhet publik jo më vonë se 7 ditë para zhvillimit të saj.
3. Përbërja e Përfaqësuesve (Delegatëve)
- f) Delegatët janë përfaqësuesit e deleguar nga anëtarësia e Koalicionit sipas raportit 1 me 10 (1 delegat për 10 anëtarë)
 - g) Numri i delegatëve përcaktohet proporcionalisht me numrin e anëtarëve në secilën njësi organizative.
 - h) Çdo delegat mandatohet nga 10 anëtarë.
 - i) Delegatët mandatohen nga anëtarët me shkrim apo me autorizim online.
 - j) Përfaqësimi në Asamble duhet të jetë proporcional me numrin e anëtarëve në zonat lokale apo në diasporë, duke siguruar që çdo njësi lokale të ketë përfaqësim të drejtë në raport me shtrirjen e Koalicionit.
 - k) Lista e delegatëve publikohen 24 orë përpara mbledhjes së Asamblesë dhe verifikohen nga Komisioni i Procedurave Statutore që zgjidhet me votim të hapur në fillim të Asamblesë, për të siguruar ligjshmërinë.
4. Të Drejtat dhe Detyrat e Delegatëve. Delegatët kanë të drejtë të:
- d) Marrin pjesë në diskutime dhe të propozojnë rezoluta.
 - e) Votojnë për çështjet që i parashtrohen Asamblesë, përfshirë zgjedhjen e organeve të larta drejtuese dhe miratimin e kandidatëve për deputetë.
 - f) Kërkojnë raportim nga organet ekzistuese të partisë.
 - g) Delegatët janë të detyruar të përfaqësojnë qëndrimet e strukturës që i ka zgjedhur ose të deklarojnë pavarësinë e tyre në qëndrimet e tyre, duke pasur parasysh platformën dhe interesat e përgjithshme të partisë.
5. Funkcionet e Asamblesë Qytetare
- e) Zgjedhja e organeve drejtuese me votë të fshehtë:
 - a. Kryetarin e partisë.
 - b. Këshillin e Bashkëveprimit.
 - c. Komisionin e Transparencës dhe Auditimit.
 - d. Miratimi i kandidatëve për deputetë (delegatët shqyrtojnë dhe miratojnë listën e propozuar të kandidatëve për deputetë, duke respektuar kriteret e statutit, rregulloreve dhe të ligjit).
 - f) Njohjen e fraksioneve kryesore dhe periferike duke miratuar propozimin për fraksion të mbështetur nga 15% (“fraksion kryesor”) dhe 5% (“fraksion i vogël”) të anëtarësisë. Përfaqësuesit e zgjedhur nga fraksionet kanë të drejtë të përfaqësohen në Këshillin e Bashkëveprimit sipas parimit 1 përfaqësues për fraksionet periferike dhe 2-3 përfaqësues për fraksionet kryesore.
 - g) Ndryshimet në statut (propozimet për ndryshime në statut diskutohen dhe miratohen me shumicën e cilësuar të votave të delegatëve).
 - h) Propozimin, Miratimin e rezolutave, mocioneve dhe dokumenteve strategjike:

- i) Rezolutat që përcaktojnë drejtimet strategjike dhe politike të partisë miratohen nga Asambleja.
 - j) Raportet e organeve ekzistuese (Asambleja shqyrton dhe miraton raportet e organeve drejtuese dhe të Komisionit të Transparencës dhe Auditimit.)
6. Procesi i Vendimmarrjes
- a. Në çdo rast bëhet verifikimi i mandateve të pjesëmarrësve
 - b. Asambleja në varësi të kushteve dhe mundësive zhvillohet në formë të alternuar të prezencës fizike dhe virtuale për ti dhënë mundësi dhe garantuar çdokujt sidomos përfaqësuesve të diasporës dhe mërgatës, që të marrin pjesë në procesin vendimmarrës. Është detyrë e Këshillit Bashkëveprues që ti garantojë kushtet e prezencës përfaqësuesve që marrin pjesë nëpërmjet platformave online duke garantuar edhe verifikimin e mandateve dhe garantojë shprehjen dhe pranimin e lirë të vullnetit të tyre në kushtet e sigurisë së plotë dixhitale.
 - c. Vendimet e Asamblesë merren me shumicën e thjeshtë të votave të delegatëve të pranishëm, përveç rasteve kur statuti kërkon një shumicë të cilësuar.
 - d. Votimet për zgjedhjen e personave janë të fshehta ndërsa ato për vendimet e tjera janë të hapura, përveç rasteve kur anëtarët e Asamblesë vendosin ndryshe.
 - e. Rezultatet e votimeve regjistrohen dhe bëhen publike menjëherë pas përfundimit të seancës.
7. Transparenca, Publikimi dhe regjistrimi i ndryshimeve që kërkon ligji
- a. Raportet dhe vendimet e Asamblesë publikohen brenda 48 orësh nga përfundimi i saj dhe i bëhen të njohura anëtarësisë së partisë dhe publikut.
 - b. Paraqitja e dokumentacionit në Gjykatë bëhet brenda afateve ligjore që përcakton legjislacioni dhe procedura gjyqësore.

Neni 13

KËSHILLI I BASHKËVEPRIMIT TË KOALICIONIT

Këshilli i Bashkëveprimit i Koalicionit është Organi më i lartë vendimmarrës midis 2 Asambleve Qytetare dhe përbëhet nga përfaqësuesit e zgjedhur në Asamblenë Qytetare me minimumi 31 persona. Ai përbëhet nga aq anëtarë sa vendosen në Asamblenë e Radhës.

1. Ata garantojnë respektimin dhe ecurinë demokratike të Koalicionit dhe marrin çdo vendim të nevojshëm për mirëfunksionimin e Koalicionit.
2. Ata zgjedhin me vullnet të lirë Këshillin Koordinativ me funksionet e një kryesie kolegjiale (me aq anëtarë sa vendos Këshilli i Bashkëveprimit pas Asamblesë së radhës.
3. Ai siguron vijimin e qeverisjes dhe vendimmarrjes së partisë në përputhje me strategjitë dhe vendimet e miratuara nga Asambleja Qytetare.
4. Funksionet Kryesore
 - a. Shqyrton dhe miraton vendime të rëndësishme politike, organizative dhe strategjike midis mbledhjeve të Asamblesë Qytetare.
 - b. Mbikëqyr dhe monitoron zbatimin e vendimeve të Asamblesë Qytetare nga Kryesia dhe organet e tjera të partisë.
 - c. Miraton programet dhe buxhetet afatmesme të partisë, bazuar në propozimet e Këshillit Koordinativ, Kryetarit dhe Sekretarit të Përgjithshëm apo edhe anëtarë të tjerë të Këshillit Koordinativ.

- d. Shqyrton dhe miraton nisma politike dhe strategji zgjedhore të propozuara nga Kryesia ose nga struktura të tjera të partisë.
5. Mbledhjet dhe Procedurat
 - a. Këshilli mbledhet të paktën një herë në tre muaj ose sa herë që kërkohet nga Këshilli Koordinativ, kryetari, sekretari i përgjithshëm ose nga një e treta e anëtarëve të tij apo 1/3 e Këshillit Koordinativ.
 - b. Mbledhjet thirren dhe drejtohen nga Kryetari i Partisë ose nga një anëtar i caktuar nga Kryesia në mungesë të tij.
 - c. Çdo vendim i Këshillit merret me shumicën e thjeshtë të votave të anëtarëve të pranishëm, përveç rasteve kur statuti kërkon një shumicë të cilësuar.
 6. Kompetencat e Kufizuara
 - a. Këshilli nuk mund të miratojë ndryshime në statut ose të zgjedhë organe drejtuese; këto janë kompetenca ekskluzive të Asamblesë Qytetare me përjashtim të rasteve kur cakton në mënyrë të përkohshme zëvendësues të tyre të përkohshëm nëse funksionet e tyre janë të domosdoshme për mbarëvajtjen e partisë.
 - b. Ai nuk mund të marrë vendime që janë në kundërshtim me strategjitë ose direktivat e miratuara nga Asambleja Qytetare.
 7. Kompetenca të jashtëzakonshme të mbledhjes së Jashtëzakonshme
 - a. Këshilli ka të drejtë të marrë vendime të rëndësishme në emër të Asamblesë kur për arsye të pamundura kohore duhen vendime thelbësore dhe të çastit siç mund të jenë vendimet për koalicione parazgjedhore, lista kandidatësh për zgjedhjet parlamentare dhe lokale kur koha e bën të pamundur thirrjen e Asamblesë së jashtëzakonshme.
 - b. Mbledhja e jashtëzakonshme thirret edhe brenda 24 orësh veç në rastet kur afatet ligjore detyrojnë marrjen e vendimeve të çastit.
 8. Lidhja me Kryesinë dhe Asamblenë Qytetare
 - a. Vendimet e Këshillit janë detyruese për Kryesinë dhe strukturat e tjera të partisë, përveç rasteve kur Asambleja Qytetare vendos ndryshe.
 - b. Këshilli raporton në mënyrë periodike për aktivitetet dhe vendimet e tij në Asamblenë Qytetare.
 9. Përgjegjësia dhe Llogaridhënia
 - a. Këshilli mban përgjegjësi për zbatimin e drejtë të funksioneve të tij dhe është i detyruar të japë llogari në Asamblenë Qytetare për çdo vendim të marrë.
 - b. Anëtarët e Këshillit duhet të ndjekin një standard të lartë transparence dhe përgjegjshmërie në kryerjen e detyrave të tyre.

Mbledhja e Këshillit të Bashkëveprimit organizohet fizikisht brenda mundësive nëpërmjet pjesëmarrjes së kombinuar fizike dhe virtuale në platformat online sipas praktikave më të mira të aplikuara nga Komisionet e Ligjeve në Kuvendin e Shqipërisë. Mbledhjet njoftohen paraprakisht për të gjithë anëtarët e strukturës jo më vonë se 7 ditë përpara.

Neni 14

KËSHILLI KOORDINATIV

Këshilli i Përkohshëm Koordinativ ka funksionin e Kryesisë kolegjiale.

Ajo përbëhet nga minimumi 11 persona dhe është në numër tek dhe mandati i tyre zgjat në varësi të vendimeve të votuara të Asamblesë Qytetare.

Kompetencat e Këshillit të Përkohshëm Koordinativ, janë:

1. Këshilli zgjedh me vullnet të lirë
 - a. Sekretarin e Përgjithshëm
 - b. Nënkyetarët (minimumi 2)
 - c. Koordinatorin e Organizimit,
 - d. Sekretarin e Këshillit,
 - e. disa Koordinatorë sipas fushave që kanë funksionin e anëtarit të Këshillit të Koordinativ.
2. Propozimin dhe miratimin e Koordinatorëve Lokalë, përfaqësuesit e klubeve lokale patriotike, ata në diasporë dhe mërgatë që do të ndihmojnë organizimin e Koalicioni në nivel lokal dhe mërgatë.
3. Ndihma dhe Mbikëqyrja e procesit të regjistrimit të anëtarësisë, krijimi i **klubeve patriotike** në nivel lokal dhe në mërgatë me anëtarët themelues, zgjedhja e Përfaqësuesve të Qytetarëve, dhe garantimi i ndjekjes së procedurave demokratike dhe të rregullta.
4. Marrja e vendimeve për qëndrimet dhe reagimet e Koalicioni në kuadër të të drejtave dhe përgjegjësisë që ka një formacion politik para regjistrimit në Gjykatë.
5. Miratimi i Raporteve të Koordinatorëve.
6. Diskutimi dhe miratimi i akteve të nevojshme për përfundimin me sukses të dokumentacionit të regjistrimit juridik që propozohen nga Kryetari.
7. Miratimi i mandateve të Përfaqësuesve Lokalë që do të dalin nga procedura e organizimit të Koalicionit.
8. Miratimi i akteve dhe procedurave të organizimit të Asamblesë Themeluese të Përfaqësuesve të Koalicionit.
9. Organizimi i Asamblesë së radhës apo të jashtëzakonshme.
10. Kompetenca të jashtëzakonshme të mbledhjes së Jashtëzakonshme:
 - a. Këshilli ka të drejtë të marrë vendime të rëndësishme në emër të Këshillit të Bashkëveprimit kur për arsye të pamundura kohore duhen vendime thelbësore dhe të çastit siç mund të jenë vendimet për koalicione parazgjedhore, lista kandidatësh për zgjedhjet parlamentare dhe lokale kur koha e bën të pamundur thirrjen e Këshillit të Bashkëveprimit të jashtëzakonshëm.
 - b. Mbledhja e jashtëzakonshme thirret edhe brenda 24 orësh veç në rastet kur afatet ligjore detyrojnë marrjen e vendimeve të çastit.

Mbledhja e Këshillit Koordinativ organizohet fizikisht brenda mundësive nëpërmjet pjesëmarrjes së kombinuar fizike dhe virtuale në platformat online sipas praktikave më të mira të aplikuara nga Komisionet e Ligjeve në Kuvendin e Shqipërisë. Mbledhjet njoftohen paraprakisht për të gjithë anëtarët e strukturës.

Neni 15

KRYETARI DHE NËNKRYETARËT

1. Roli dhe Përfaqësimi

- a) Kryetari është përfaqësuesi më i lartë institucional i partisë, duke përfaqësuar atë në marrëdhëniet me institucionet shtetërore, partitë politike të tjera, dhe organizatat ndërkombëtare.
 - b) Ai/ajo vepron si figura unifikuese brenda partisë, duke promovuar bashkëpunimin ndërmjet strukturave dhe anëtarësisë.
 - c) Nënkryetarët zëvendësojnë (me miratim të kryetarit për shkak të zgjedhjes së tij nga Asambleja) atë në çdo nivel përfaqësimi.
2. Thirrja dhe Drejtimi i Mbledhjeve
- a) Kryetari thërret dhe kryeson mbledhjet e Kryesisë së Partisë, duke siguruar zbatimin e rendit të ditës të miratuar nga organet përkatëse.
 - b) Siguron që diskutimet dhe vendimmarrja në Kryesi të jenë në përputhje me statutin dhe platformën e partisë.
3. Koordinimi me Organet e Tjera
- a) Kryetari bashkëpunon ngushtë me Sekretarin e Përgjithshëm dhe Nënkryetarët për të zbatuar vendimet e Asamblesë Qytetare dhe të Kryesisë.
 - b) Mbështet Komisionin e Transparencës dhe Auditimit në kryerjen e detyrave të tij, duke siguruar aksesin në informacionin e nevojshëm.
4. Mandati dhe Kufizimet
- a) Kryetari zbaton vendimet e marra nga organet kolegjiale të partisë dhe nuk ka të drejtë të veprojë jashtë vendimeve të miratuara nga Kryesia apo Asambleja Qytetare.
 - b) Ai/ajo nuk mund të marrë vendime individuale që prekin strukturën organizative, politikat strategjike apo financat e partisë pa aprovimin paraprak të Kryesisë.
5. Përgjegjësitë Kryesore
- a) Mbikëqyr zbatimin e vendimeve të Asamblesë Qytetare dhe Kryesisë së Partisë.
 - b) Paraqet raporte periodike mbi gjendjen dhe progresin e partisë në mbledhjet e Kryesisë dhe Asamblesë Qytetare.
 - c) Propozon nisma politike dhe organizative për t'u shqyrtuar nga Kryesia ose Asambleja Qytetare.
 - d) Përfaqëson partinë në zgjedhje, duke koordinuar përgatitjet dhe fushatat zgjedhore në bashkëpunim me strukturat organizative.
6. Zëvendësimi i Kryetarit
- a) Në rast të mungesës ose pamundësisë së përkohshme të Kryetarit për të ushtruar detyrat e tij, kompetencat e tij kalojnë përkohësisht te një nga Nënkryetarët, i caktuar nga Kryesia.
 - b) Në rast dorëheqjeje, përfundimi të mandatit, ose largimi të parakohshëm, Kryesia thërret Asamblenë Qytetare për të zgjedhur një kryetar të ri.
7. Transparenca dhe Llogaridhënia
- a) Kryetari është i detyruar të paraqesë një raport të detajuar të veprimtarisë së tij në Asamblenë Qytetare dhe Kryesi në fund të çdo periudhe raportimi.
 - b) Për çdo veprim të tij jashtë kompetencave të përcaktuara, Kryetari mban përgjegjësi të plotë para organeve drejtuese të partisë.

Funksionet dhe Përgjegjësitë e Sekretarit të Përgjithshëm të Partisë

1. Roli dhe Përfaqësimi
 - a. Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës për administrimin e përditshëm të partisë dhe zbatimin e vendimeve të marra nga organet kolegjiale.
 - b. Ai/ajo vepron si ndërmjetësi kryesor midis strukturave lokale dhe qendrore të partisë, duke siguruar koordinim të efektshëm.
2. Administrimi dhe Organizimi
 - a. Mbikëqyr funksionimin e aparatit administrativ të partisë, përfshirë burimet njerëzore, financat dhe logjistikën.
 - b. Koordinon përgatitjen dhe zbatimin e planeve operative të partisë në përputhje me strategjinë e miratuar nga Kryesia dhe Asambleja Qytetare.
3. Zbatimi i Vendimeve
 - a. Siguron që vendimet e Asamblesë Qytetare, Kryesisë dhe Këshillit të Bashkëveprimit të zbatohen në kohë dhe në mënyrë efikase.
 - b. Harton dhe ndjek realizimin e planit të punës për strukturat e partisë në nivel lokal dhe kombëtar.
4. Raportimi
 - a. Paraqet raporte të rregullta në Kryesi mbi gjendjen e përgjithshme organizative dhe mbi ecurinë e aktiviteteve të partisë.
 - b. Përgatit raportin vjetor të veprimtarisë së partisë dhe e paraqet për miratim në Asamblenë Qytetare.
5. Menaxhimi Financiar
 - a. Bashkëpunon me Komisionin e Transparencës dhe Auditimit për të siguruar një menaxhim të përgjegjshëm dhe transparent të financave të partisë.
 - b. Mbikëqyr përgatitjen e buxhetit dhe shpenzimeve, duke siguruar përputhjen me vendimet e organeve drejtuese.
6. Mbështetja e Kryesisë dhe Delegatëve
 - a. Asiston Kryetarin dhe Nënkryetarët në përmbushjen e detyrave të tyre.
 - b. Siguron dokumentacionin dhe mbështetjen logjistike për mbledhjet e Kryesisë dhe të Asamblesë Qytetare.
7. Koordinimi i Zgjedhjeve
 - a. Është përgjegjës për organizimin e procesit të zgjedhjeve brenda partisë, përfshirë përgatitjen dhe menaxhimin e procesit të zgjedhjes së delegatëve dhe organeve drejtuese.
 - b. Mbikëqyr koordinimin e fushatave zgjedhore, duke bashkëpunuar me strukturat vendore dhe grupet përgjegjëse.
8. Përgjegjësia dhe Llogaridhënia
 - a. Sekretari i Përgjithshëm mban përgjegjësi për administrimin e partisë dhe është i detyruar të japë llogari për veprimtarinë e tij në Kryesi dhe Asamblenë Qytetare.
 - b. Ai/ajo vepron brenda kufijve të kompetencave të caktuara nga statuti dhe nuk mund të marrë vendime që bien në kundërshtim me vendimet e organeve kolegjiale.
9. Zëvendësimi

- a. Në rast të mungesës së përkohshme të Sekretarit të Përgjithshëm, Kryesia mund të caktojë një nga nënkryetarët për të ushtruar përkohësisht funksionet e tij.
- b. Në rast dorëheqje apo humbje të mundësisë për të ushtruar detyrën, thirrret Këshilli i Bashkëveprimit për të zgjedhur një Sekretar tjetër të Përgjithshëm.

Neni 17

FUNKSIONET DHE PËRGJEGJËSITË E KOMISIONIT TË TRANSPARENCËS, AUDITIMIT DHE GARANTIMIT TË RESPEKTIMIT TË PROCEDURAVE STATUORE

1. Roli dhe Përbërja
 - a. Komisioni i Transparencës, Auditimit dhe Garantimit të Respektimit të Procedurave Statuore është një organ i pavarur brenda partisë, përgjegjës për mbikëqyrjen e veprimtarive financiare, administrative, organizative dhe respektimin e procedurave të parashikuara në statut duke luajtur dhe rolin e gjykatës së partisë.
 - b. Komisioni përbëhet nga 3 deri në 5 anëtarë, të zgjedhur nga Asambleja Qytetare për një mandat që zgjat të paktën sa dy asamble zgjedhore por jo më të gjatë se 4 vjet.
 - c. Anëtarët duhet të kenë integritet të lartë moral dhe profesional, me njohuri të thelluara në menaxhimin financiar, auditim, juridik dhe administrativ.
2. Përgjegjësitë Kryesore
 - a. Mbikëqyr dhe kontrollon përdorimin e fondeve dhe burimeve të partisë për të siguruar përputhjen me ligjet, statutin dhe vendimet e organeve drejtuese.
 - b. Kryen auditime të rregullta vjetore dhe të jashtëzakonshme për të vlerësuar menaxhimin financiar, administrativ dhe organizativ të partisë.
 - c. Shqyrton raportet financiare dhe aktivitetet e tjera të strukturave të partisë, duke siguruar që burimet të përdoren në mënyrë transparente dhe efikase.
 - d. Siguron respektimin e procedurave të parashikuara nga statuti në të gjitha vendimmarrjet dhe proceset e brendshme të partisë.
3. Kompetencat mbi Ankimet dhe Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve
 - a. Komisioni ka atributet e Gjykatës së Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve
 - b. Komisioni shqyrton dhe vlerëson ankesat që lidhen me shkeljet financiare, organizative dhe procedurale brenda partisë.
 - c. Ka kompetencën të bashkëpunojë kur e sheh të nevojshme me Këshillin e Bashkëveprimit të Koalicionit për zgjidhjen e çështjeve të ngritura nga anëtarët e partisë lidhur me transparencën, auditimin ose respektimin e procedurave statutore.
 - d. Për çështje që nuk zgjidhen përmes Komisionit të Ankimeve, Komisioni mund t'i referojë ato në Këshillin e Bashkëveprimit të Koalicionit, duke përgatitur raporte të detajuara dhe rekomandime të mbështetura me prova.
 - e. Procedurat dhe Praktika e funksionimit përcaktohet nga Rregullorja e Brendshme e Koalicionit e cila duhet të miratohet nga Asambleja e parë pas regjistrimit të Koalicionit në Gjykatë.
4. Transparenca dhe Publikimi

- a. Komisioni siguron që raportet financiare dhe ato të respektimit të procedurave statutore të jenë të aksesueshme për organet drejtuese dhe, kur është e nevojshme, për anëtarësinë e partisë.
 - b. Vendimet dhe raportet kryesore të Komisionit publikohen brenda 30 ditëve nga përfundimi i shqyrtimeve dhe në raste të caktuara kur këtë e kërkon në mënyrë të drejtpërdrejtë Këshilli Koordinativ apo Këshilli Bashkëveprues, brenda 7 ditëve.
 - c. Komisioni i Transparencës dhe Auditimit publikon një raport të hollësishëm financiar çdo 6 muaj, i cili dërgohet për miratim në Këshillin Koordinativ dhe për transparencë tek anëtarët.
 - d. Mekanizmi i ndëshkimit për shkeljet financiare përcaktohet në rregulloren financiare të partisë
5. Inspektimi dhe Hetimi
- a. Komisioni ka të drejtën të inspektojë çdo dokument, burim financiar ose aktivitet që lidhet me funksionimin e partisë dhe respektimin e procedurave statutore.
 - b. Mund të kryejë hetime të posaçme për raste të dyshuara për shkelje financiare, procedurale ose abuzime, duke rekomanduar masa korigjuese në përputhje me ligjin dhe statutin.
6. Bashkëpunimi me Strukturat e Partisë
- a. Komisioni bashkëpunon ngushtë me Kryetarin, Sekretarin e Përgjithshëm, Kryesinë për të siguruar zbatimin e masave dhe rekomandimeve.
7. Përgjegjësia dhe Llogaridhënia
- a. Komisioni është i detyruar t'i paraqesë raportet dhe rekomandimet e tij strukturave vendimmarrëse të Koalicionit sipas përcaktimeve të këtij Statuti.
 - b. Anëtarët e Komisionit mbajnë përgjegjësi për objektivitetin, profesionalizmin dhe konfidencialitetin në kryerjen e detyrave të tyre.
8. Zëvendësimi i Anëtarëve
- a. Në rast dorëheqjeje, largimi ose pamundësie të përhershme të një anëtari për të ushtruar funksionet e tij, Këshilli Bashkëveprues zgjedh një anëtar të ri për të përfunduar mandatin e mbetur.

Neni 18

KËSHILLI I TË URTËVE TË KOALICIONI

Këshilli i të Urtëve përbëhet nga minimumi 5 persona të cilët mund të mos jenë anëtarë të Koalicionit por propozohen nga Këshilli Koordinues dhe nëse personat e propozuar pranojnë, i jepet një status i veçantë njohjeje.

Këshilli i të Urtëve ka rolin e një organi këshillimor por me autoritet, qëndrimet e të cilit kanë fuqi detyruese për vlerësim të angazhimeve të Këshillit Koordinativ.

Neni 19

KOORDINATORËT LOKALË

Koordinatorët Lokalë janë aktivistë të Koalicioni të cilët zgjidhen nga anëtarët lokalë sipas një procedure të përcaktuar në Rregulloren e Koalicionit që miratohet në Asamblenë e parë pas regjistrimit në Gjykatë të Koalicionit.

Ata miratohen pas verifikimit të procedurës së përfaqësimit nga Këshilli Koordinues i Koalicionit dhe u jepet mandati i përfaqësimit lokal.

Neni 20

KLUBET PATRIOTIKE

Klubet Patriotike janë struktura lokale brenda dhe jashtë Shqipërisë që përbëhen nga minimumi 5 vetë dhe që ngrihen me vullnetin e lirë të anëtarëve dhe caktojnë përfaqësuesit e tyre. Procedurat dhe rregullat e funksionimit të tyre përcaktohen në rregulloren e Koalicionit e cila miratohet në Asamblenë e parë pas regjistrimit në Gjykatë të Koalicionit.

Neni 21

ANËTARËT E KOALICIONIT

Anëtar i Koalicionit është çdo shtetas shqiptar (që jeton brenda apo jashtë Shqipërisë) që shpreh apo ka shprehur vullnetin e lirë për tu anëtarësuar në Koalicion nëpërmjet propozimit dhe miratimit të “Listë-Formulari i anëtarësimit dhe Mandatimit të Përfaqësuesve të Qytetarëve Themelues të Koalicionit ShpresOn #perShqiperine dhe miratimit të akteve themeluese të Koalicionit”

Ai ka të drejtë të zgjedhë dhe të zgjidhet në çdo nivel drejtimi dhe përfaqësimi, konform këtij Statuti. Ai ndërpret në çdo moment anëtarësimin e tij pa pasur nevojë të japë shkaqe, mjafton të dërgojë njoftimin e tij me shkrim apo virtualisht. Dorëheqja e tij konsiderohet e kryer në çastin që ky njoftim mbërrin me shkrim apo virtualisht në pikën e kontaktit të vënë në dispozicion nga Koalicioni.

Neni 22

HUMBJA E ANËTARËSISË

Anëtarësia humbet në rast se:

- a. Revokon anëtarësinë;
- b. Refuzon pagimin e kuotizacionit financiar;
- c. Vdes ose humbet zotësinë për të vepruar;
- d. Përrjashtohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme për shkak të cenimit të rëndë të dispozitave të statutit apo interesave të Shoqatës.

Bordi Drejtues ka të drejtë të pezullojë një anëtar në rast të shkeljeve të mësipërme deri në Mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme.

Procedurat teknike të humbjes së anëtarësisë dhe apelimit përcaktohet me rregullore të brendshme që miratohen në Asamblenë e radhës pas njohjes ligjore të Koalicionit.

Neni 23

PARIMET NË TË CILAT FUNKSIONON QEVERISJA E BRENDSHME DEMOKRATIKE E KOALICIONIT

1. Votimi

- a. Vendimet merren me shumicë të thjeshtë votash
- b. Procedurat për votimin, pjesëmarrjen e drejtpërdrejtë fizike, virtuale, apo të kombinuar, përcaktohen nëpërmjet rregullores së qeverisjes së brendshme të Koalicioni e cila përgatitet nga Këshilli Koordinativ dhe miratohet nga Këshilli i Bashkëveprimit.

- c. Votimi mund të jetë fizik në një forum të mbledhur apo virtualisht apo i kombinuar.
 - d. Procedurat dhe mënyrat përcaktohen në Rregullore.
 - e. Çdo anëtar i një forumi ka të drejtë të propozojë, të thërrasë mbledhjen, të votojë, të zgjidhet dhe të zgjedhë.
2. E drejta për tu bërë pjesë në Koalicioni apo forumet e saj
 - a. Çdo anëtar ka të drejtë të anëtarësohet dhe të largohet nga Koalicioni
 - b. Çdo anëtar ka të drejtë të zgjidhet dhe të zgjedhë
 - c. Përjashtimi i një anëtari të Koalicioni apo të një Forumi mund të bëhet vetëm duke respektuar parimet demokratike dhe duke i dhënë të drejtën për një proces të ndershëm dhe transparent.
 - d. Çdo anëtar ka të drejtë të kërkojë transparencën dhe njohjen me aktet e forumeve qeverisës të Koalicioni.
 3. Zbatimi i ligjit dhe transparenca
 - a. Çdo anëtar është i detyruar të zbatojë të gjitha kriteret ligjore që përcakton legjislacioni për qeverisjen e brendshme të partive politike.
 - b. Aktet që përcakton ligji, propozohen, miratohen dhe paraqiten duke respektuar procedurat e transparencës.
 4. Procedurat e brendshme demokratike
 - a. Për të garantuar një proces demokratik dhe transparent, Këshilli Koordinativ duhet të përgatisë një Rregullore të Brendshme e cila duhet të miratohet nga Këshilli i Bashkëveprimit dhe Asambleja e Përfaqësuesve.
 - b. Stafi i punësuar i nënshtrohet rregullave të legjislacionit shqiptar për marrëdhëniet në punë.

Neni 24

VLERA ZYRTARE E AKTEVE

Aktet dhe korrespondenca e Koalicioni kanë vlerë zyrtare kur ato përmbajnë emrin e plotë të Koalicioni, logon/sigllën, selinë, numrin dhe datën e regjistrimit në gjykatë, emrin dhe nënshkrimin e personit kompetent konform përcaktimeve të këtij Statuti e rregulloreve të organeve drejtuese.

Dokumentet që rregullojnë marrëdhëniet me bankat ose me organet tjera të sistemit financiar, nënshkruhen nga Kryetari, si firmë e parë dhe në mungesë të tij nga një person tjetër, por kurdoherë i pajisur me prokurë apo autorizim të siglur dhe vulosur me shkrim nga personi përgjegjës i Këshillit të Koordinimit.

KREU IV FINANCAT

Neni 25

A. BURIMET DHE PËRDORIMI I TË ARDHURAVE

1. Koalicioni ka pavarësi financiare.
2. Burimet e saj financiare sigurohen konform legjislacionit shqiptar për partitë politike dhe raportohen mbi parimin e transparencës publike. Të dhënat për burimet financiare, si dhe

për shpenzimet e tyre publikohen kurdoherë. Rregullat e monitorimit, të mbikëqyrjes dhe të auditimit të burimeve financiare e materiale përcaktohen në rregullore.

3. Burimet financiare dhe materiale të Koalicioni përbëhen nga kuotat e anëtarësisë, nga fondet publike, duke përfshirë edhe ndihmën financiare në masën e caktuar në Buxhetin e Shtetit të miratuar me ligj nga Kuvendi, fondet jopublike, të cilat janë dhurimet financiare, dhurimet në natyrë, shërbimet, sponsorizimet, kreditë apo garancitë e ndryshme, si edhe çdo transaksion tjetër financiar.
4. Koalicioni mund t'i përdorë asetet e veta për veprimtari ekonomiko-shoqërore të karakterit të botimeve, shtypshkrimeve, shërbimeve, sipas legjislacionit në fuqi.
5. Lejohen dhuratat dhe ndihmat që vijnë nga parti ose bashkime ndërkombëtare partish veç në rastet kur lejohen nga legjislacioni shqiptar, nga organizata e fondacione politike, vendase e të huaja, si dhe nga individë, persona fizikë e juridikë privatë vendas konform legjislacionit shqiptar dhe ndalimeve përkatëse.
6. Koalicioni regjistron në një regjistër të posaçëm, sipas formatit të miratuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, shumën e fondeve të përfituara nga çdo person fizik ose juridik, si dhe të dhëna që lidhen me identifikimin e qartë të dhuruesit. Në çdo rast, dhuruesi, në kohën e dhurimit, nënshkruan detyrimisht një deklaratë dhurimi, sipas formatit të miratuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Lista e personave, që dhurojnë shumat që përcakton ligji si detyrim raportimi, si dhe vlera përkatëse, duhet të bëhen kurdoherë publike.
7. Dhurimi i fondeve jopublike, me vlerë më të madhe se 100 mijë lekë, bëhet vetëm në një llogari të posaçme, të hapur në një bankë nga Koalicioni. Personi përgjegjës për financat, brenda një muaji nga krijimi i partisë politike, deklaron pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve numrin e llogarisë bankare, të hapur për këtë qëllim. Ndalohet përfitimi i fondeve jopublike, kryer nga subjekte që nuk deklarojnë identitetin e tyre apo identiteti i të cilave është i papërcaktuar qartë nga partia politike përfituese e fondit jopublik.
8. Çdo shpenzim i kryer nga Koalicioni kryhet dhe dokumentohet duke respektuar legjislacionin tatimor në fuqi.

Neni 26

ZBATIMI I PROCEDURAVE, PROCESVERBALET DHE DEKLARATAT

Koalicioni duhet të mbajë procesverbal për mbledhjet dhe vendimet e organeve të saj.

Të gjithë veprimet në lidhje me administrim pasurie duhet të regjistrohen në procesverbale. Deklaratat e Koalicioni që kanë lidhje me krijimin, modifikimin dhe përfundimin e të drejtave dhe detyrimeve, duhet të përmbajnë emrin: "Koalicioni Shpreson #perShqiperine", Selinë, Adresën e Koalicionit, dhe emrin e organit apo përfaqësuesit të shoqatës që e publikon si dhe datën e dokumentit përkatës. Po ashtu duhen edhe të dhënat e adresës dhe kontakteve të komunikimit. Procedurat e mbledhjeve aplikohen nga organet drejtuese duke garantuar transparencë dhe praktikat dhe normat më të mira të qeverisjes së organizatave jofitimprurëse. Në çdo forum që merr vendime mbi akte të Koalicioni, merren masa që procedurat të jenë transparente dhe të ligjshme dhe organet drejtuese janë kompetente për të garantuar që rregullat dhe procedurat të miratohen paraprakisht me votim të thjeshtë të anëtarëve.

Ruajtja e të dhënave tatimore

Koalicioni ka detyrimin të ruajnë të dhënat tatimore në përputhje me rregullat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë.

Publikimi i pasqyrave financiare

Pasqyrat financiare të shoqatës publikohen në përputhje me rregullat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare.

Bilancet dhe kontrolli

Veprimet ekonomiko-financiare të Koalicioni mbyllet në fund të vitit financiar, me 31 dhjetor.

Në fund të çdo viti fiskal, personat e ngarkuar nxjerrin bilancin financiar ekonomik, i cili shqyrtohet nga Këshilli Koordinativ, jo më vonë se një muaj nga afati maksimal i dorëzimit/mbylljes së tij.

Për të kontrolluar e siguruar një veprimtari ekonomike efektive të Koalicionit, Këshilli Koordinativ apo Këshilli Bashkëveprues me vendim të Mbledhjes së tij, ka të drejtë të urdhëroje ushtrimin e kontrollit mbi këtë veprimtari në çdo kohë e për çdo rast që ai e gjykon të nevojshëm. Këtë të drejtë e gëzon edhe Këshilli Bashkëveprues por edhe me kërkesë të 10% të anëtarëve të Asamblesë së Përfaqësuesve.

KREU V

TRANSFORMIMI DHE SHPËRNDARJA

Neni 27

TRANSFORMIMI

Koalicioni mund të transformohet konform ligjeve shqiptare me vendim të marrë me shumicë të thjeshtë të anëtarëve të Asamblesë. Transformimi ka të bëjë me bashkimin me një parti apo shkrirjen me disa njëkohësisht, apo ndahet konform procedurave që përcakton legjislacioni shqiptar por për këtë duhet vendimi i Asamblesë së Përfaqësuesve.

Çdo vendim për transformim të partisë duhet të aprovohet nga shumica e thjeshtë e delegatëve të Asamblesë Qytetare, dhe dokumentacioni i plotë i procesit duhet të depozitohet në Gjykatë për verifikim.

Neni 28

SHPËRNDARJA

Koalicioni shpërndahet atëherë kur merr vendim Gjykata ose Asambleja me votim të minimumit të 2/3 të delegatëve të Asamblesë Qytetare, dhe dokumentacioni i plotë i procesit duhet të depozitohet në Gjykatë për verifikim.

Kur vendoset shpërndarja e Koalicionit, pushohet veprimtaria e saj dhe vihet në likuidim.

Likuidimi bëhet nga Komisioni i Likuidimit i cili caktohet nga Asambleja e Koalicionit.

Personat që kryejnë likuidimin veprojnë në bazë të Kodit Civil dhe këtij Statuti.

Pas likuidimit të kreditorëve, pasuria vendoset ti jepet (sipas vendimit të anëtarëve që marrin pjesë në Asamblesë që ka vendosur shpërndarjen) një subjekti që nuk ka qëllime fitimi apo një partie tjetër. Përfshihet dhënia ndaj një apo disa individëve, një subjekti fitimprurës apo një institucioni publik shtetëror. Është e palejueshme që kjo pasuri ti jepet anëtarëve të Koalicionit.

Pas miratimit të raportit përfundimtar të likuidimit Shoqata çregjistrohet nga likuidatori.

Për çdo paqartësi zbatohen normat e përcaktuara në legjislacionin shqiptar për OJFtë dhe atë tregtar (procedurat e likuidimit).

KREU VI

DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 29

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Ky Statut hyn në fuqi me vendim Gjykate pasi është miratuar dhe fuqitë para dhe prapa vepruese përcaktohen nga legjislacioni shqiptar.

Neni 30

REFERENCA LIGJORE

Për sa nuk është parashikuar në këtë Statut aplikohen normat e legjislacionit Shqiptar ne fuqi dhe praktikat më të mira të së drejtës ndërkombëtare.

Në çdo rast, për çdo paqartësi apo rregullim të brendshëm, zbatohen përcaktimet e legjislacionit shqiptar për organizimin dhe qeverisjen e brendshme të partive politike.

Neni 31

DISPOZITA TË PËRKOHSHME PARA THEMELIMIT

Komisioni Nismëtar për ndërmarrjen e iniciativës për themelimin, regjistrimin e anëtarësisë, propozimin e akteve, organizimin dhe regjistrimin në gjykatë përbëhet nga këta persona